



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:210083

Datë: 14.11.2024

Numri i dokumentit: 06456389

C.nr.696/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike-kontestimore të paditësit N.A, fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Sh.Znga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale për Arsim (DKA), me bazë juridike, kompensim për orët e mësimit gjatë fundjavave, jashtë seancës, me datë 14.11.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit N.A nga fshati Pataqan i Poshtëm, Komuna e Rahovecit, me të cilën ka kërkuar që të OBLIGOHET e paditura Komuna e Rahovecit - DKA, që në emër të kompensimit të të ardhurave personale për punën për fundjavë për periudhën nga data 09.10.2021 deri me 14.01.2023 ti paguaj pagën neto në shumë prej 492.73 euro, në emër të kontributit pensional shumë prej 55.32 euro si dhe në emër të tatimit në pagë në shumë prej 30.36 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga data 18.07.2024 (dita e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën përfundimtare.
- II. Secila palë i bart shpenzimet e saj procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.A nga Rahoveci, nëpërmjet avokatit të tij të autorizuar, me datë 18.07.2024 ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit - DKA, me të cilën ka kërkuar që të Obligohet e paditura, që në emër të kompensimit të të ardhurave personale për punën për fundjavë për periudhën nga data 09.10.2021 deri me 14.01.2023 ti paguaj pagën neto në shumë prej 492.73 euro, në emër të kontributit pensional shumë prej 55.32 euro si dhe në emër të tatimit në pagë në shumë prej 30.36 euro, e të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%.

Ndër të tjera në padi ka theksuar se paditësi është e punësuar te e paditura, në marrëdhënie të rregullt të punës. Paditësi nuk është paguar për ditët për të cilat ka punuar gjatë fundjavës dhe pushimit, për të cilat konsiderohet se paditësja ka punuar jashtë orarit. Paditësit në bazë të nenit 56, par 2 nën par 2.5, Ligji nr. 03/L-212 i Punës, i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, përkatësisht 50% në orë për punë gjatë fundjavës. Duke qenë se e paditura nuk e ka kryer detyrimin e saj që paditësit të ja kompensoj diferencën e pagave shtesë siç parashihen me ligj, ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e kësaj kërkesë.

Gjykata me aktvendimin C.nr.696/2024, të datës 09.10.2024, e ka obliguar të paditurën që të përgjigjet në padi, nën kërcënimin e pasojave procedurale, të cilin vendim e paditura, e ka pranuar me datë 11.10.2024.

E paditura me datë 06.11.2024, ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit. E njëjta ka theksuar që të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv në këtë çështje kontestimore. Padia është e pa themeltë dhe e pa bazuar ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – DKA. Ka shtuar se MASHT dhe SBASHK nuk kanë zbatuar asnjë nga dispozitat e nenit 46 për angazhimin e përbashkët të zbatimit të dispozitave që kanë implikime financiare. Baza ligjore për sigurimin e fondeve për realizimin e buxhetit të nevojshëm sipas nenit 35 paragrafët 5,7 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit, nga hyrja në fuqi e Kontratës Kolektive të Arsimit, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave asnjëherë nuk kanë ndarë mjetet financiare për Komunar, respektivisht për këtu të paditurën Komuna e Rahovecit, me qëllim të ndarjes së buxhetit të nevojshëm të përcaktuar në nenin 35 paragrafët 5, 7 dhe 9 të Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës. Paditësja nuk i ka shtjerë të gjitha mundësitë ligjore në procedurën administrative, për këtë qëllim Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Rahovecit, ka themeluar një komision të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit, me qëllim të verifikimit të gjendjes faktike për të gjithë punëtorët e arsimit të cilët kanë pasur në Komunën e Rahovecit – DKA.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 399 paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.”*, ndërsa në paragrafin 2 është përcaktuar se *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.”* dhe ka arritur në përfundimin se janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e vendimit meritor jashtë seance me të cilin duhet të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pathemeltë.

Nga përmbajtja e kontratës së paditësit, përkatësisht nenit II të saj, thuhet se *“Punë kryesi është i obliguar ta realizojë planë programin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/saj të punës”*.

MASHT, duke vepruar konform Ligjit për Arsimin Parauniversitar, ka nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar planprogramin mësimor, konkretisht me datë 12.08.2022 ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ 05/2022, për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023.

Në nenin 1 të këtij udhëzimi përcaktohet se “*Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të përcaktoj fillimin dhe mbarimin e vitit shkollor, respektivisht të vitit mësimor, sipas niveleve, pushimin dimëror, pushimin pranveror, festat publike për nxënësit e shkollave fillore, klasave parafillore, shkollave të mesme të ulëta, shkollave mesme të larta, institucioneve parashkollore dhe qendrat burimore për mësim dhe këshillim*”.

Në nenin 8 të këtij udhëzimi përcaktohet se “*Ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës*”;

1. *Për nxënësit e shkollës së mesme të lartë-maturantët, janë të obliguar 160 ditë mësimi, tridhjetedy (32) javë,*

2. *Për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të, janë të obliguara, 175 ditë mësimi. 35 javë.*

3. *Për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët parafillore, janë të obliguara 185 ditë mësimi, 37 javë.*

4. *Institucionet parashkollore, duhet të marrin për bazë festat zyrtare në pajtim me nenin 7 të këtij udhëzimi.*

5. *Pushimet verore për institucionet parashkollore rregullohen nga institucionet parashkollore në bashkëpunim me DKA-në, gjatë periudhës kohore 1 korrik deri më 15 gusht, ku brenda kësaj periudhe kohore planifikojnë pushimin vjetor në bazë të ligjit të punës.*

6. *Në Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim me konvikt, në rast se festa është gjatë ditëve të punës, u lejohet të planifikojnë zëvendësimin e mësimit, pa humbur nga ditët dhe javët e obliguara për mësim.*

7. *Për çdo ndryshim të kalendarit shkollor, MASHTI merr vendim të veçantë”, pra nga përkufizimi i kësaj dispozite, del se Mashti me akt nënligjor përcakton ditët dhe javët e obliguara të mësimit dhe të punës dhe se ndryshimi i këtij Udhëzimi, sipas nenit 8 par. 7 të tij, bëhet me vendim”.*

Para fillimit të vitit shkollor 2022/2023, SBASHKU, me datë 25.08.2022 kishte vendos që të futet në grevë si rrjedhojë e grevës, mësimdhënësit nuk i kanë përmbushur detyrimet që dalin nga kontratat e tyre të punës, përkatësisht nuk kanë implementuar Udhëzimin Administrativ nr. 05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023.

Pasi që me datë 03.10.2022 SBASHKU e kishte ndërprerë grevën, MASHT konform nenit 8 par. 7 të UA.nr.05/2022, ka nxjerr vendimin numër 0113/453 të datës 04.10.2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kalendarit të Vitit Shkollor 2022-2023, me të cilin vendim ishte përcaktuar që të zëvendësohen ditët e humbura gjatë grevës, ashtu që ishte vendosur që kalendari mësimor i vitit shkollor 2022/2023 të realizohet në edhe në tetë (8) ditë të fundjavës, konkretisht ditën e shtunë, të datave 15.10.2022, 22.10.2022, 29.10.2022, 12.11.2022, 26.11.2022, 10.12.2022, 24.12.2022,

14.01.2023. Ndërkaq, po me këtë vendim (pika 9) ishte përcaktuar që mësimdhënësit të cilët nuk kanë marrë pjesë në grevë të zbatojnë kalendarin mësimor të përcaktuar me UA.nr.05/2022 (Pra të njëjtit nuk kanë punuar gjatë ditëve të shtune).

Po ashtu duhet theksuar faktin se pavarësisht se në Ligjin për Grevat, në nenin 18 par. 1 të tij thuhet se *“Gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet, që rrjedhin nga Kontrata e Punës”*, ndërsa me plotësim ndryshimin e Ligjit për Grevat, neni 7 par. 1, përcakton se *“1. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas togfjalëshit “Kontrata e Punës ” shtohet fjalia “duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punua”, pra përcaktohet që pezullohen të drejtat nga kontrata e punës, duke përfshirë edhe pagesën e mësimdhënësve si grevist, është fakt i njohur botërisht që të gjithë mësimdhënësit, duke u përfshirë edhe paditësja, gjatë periudhës së grevës ka realizuar pagën e rregullt mujore sikurse të kishte punuar.*

Nga të lartcekurat, gjykata vërteton se pretendimi i paditësit për kompensimin pagës shtesë për shkak të punës më të gjatë se sa orari i plot i punës, është në tërësi i pabazuar, për arsye se orët e punës për paditësen si në kontratën e saj të punës, janë përcaktuara në Udhëzimi Administrativ nr. 05/2022 për Kalendarin e Vitit Shkollor 2022-2023 dhe në vendimin me numër 0113/453 të datës 04.10.2022 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Kalendarit të Vitit Shkollor 2022-2023, ku për paditësen si mësimdhënëse e klasave 1-8-të, kanë qenë të përcaktuara 185 ditë mësimi, (37) javë, ndërsa në kontratën e saj të punës janë përcaktuar 20 orë mësimi në javë, përkatësisht 40 orë pune në javë, andaj paditësja me asnjë provë nuk ka argumentuar faktin se e njëjta ka punuar më gjatë se sa orari i punës së përcaktuar në UA.nr.05/2022 dhe në kontratën e saj të punës, e si rrjedhojë nuk mund të zbatohet neni 56 i Ligjit të Punës për kompensimin e punës jashtë orarit, sepse paditësja me punën e realizuara gjatë të shtunave të periudhës tetor-dhjetor 2022 dhe janar 2023, nuk ka punuar orë shtesë, por e njëjta ka zbatuar vetëm detyrimin e saj për të përmbushur orët e saj mësimore, të përcaktuara nga kontrata e punës, e në të cilën kontratë nuk janë të përcaktuara ditët e javës brenda të cilave duhet të përmbushën orët mësimore, por vetëm fondi i orëve mësimore, andaj me vendimin për plotësimin dhe ndryshimin e vitit kalendarik të vitit shkollor 2022-2023, nuk nënkupton faktin se paditësja në mënyrë burimore ka punuar orë më tepër se sa ato të përcaktuara në UA.nr.05/2022, si dhe fakti se ajo ka punuar ditëve të shtune, në asnjë formë nuk ka cenuar të drejtat e saj që rrjedhin nga Ligji për Grevat.

Gjykata vendosi si në dispozitivin II, të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Në bazë të të gjitha arsyeve që u paraqitën më lartë dhe dispozitave të lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm për Çështje Civile,
C.nr.696/2024, datë 14.11.2024

B. Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.